



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 24 shtator 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1032_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,
Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, dhe Nenin 32 paragrafin 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 7 dhe Nenit 19 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin për vazhdim të licencës për prodhim të energjisë elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 03.05.2018 nga ndërmarrja Korporata Energjetike e Kosovës –Divizioni i Gjenerimit “KEK SH.A.”-TC Kosova “A”, adresa: rruga “Nënë Tereza nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
- Kërkesën për shtyrje afati të licencës për prodhim të energjisë elektrike për TC Kosova A, e datës 03.05.2018; dhe
- “Njoftimin” për Leje Mjedisore të Integruar”, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me Nr. Prot: 1559-2/18, të datës 11.04.2018,

në seancën e mbajtur me datë 24 shtator 2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. I VAZHDOHET** licenca për prodhim të energjisë elektrike Korporatës Energjetike të Kosovës – Divizioni i Gjenerimit (KEK SH.A.),TC “Kosova A”, me numër licence ZRRE/Li_05/17_A, për periudhën nga **04 tetor 2018** deri **04 tetor 2019**.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 03.05.2018 ka pranuar Kërkesën për Vazhdim Licence për prodhim të energjisë elektrike të KEK Sh.a. – Divizioni i Gjenerimit TC “Kosova A”, për periudhën nga 04.10.2018 deri me 04.10.2022.
- o KEK SH.A po ashtu ka dorëzuar Aplikacionin për vazhdim licence për prodhim të energjisë elektrike dhe dokumente/dëshmi shtesë, të kërkuara nga Rregullatori, për vazhdim licence.
- o Në pamundësi që KEK SH.A të pajiset me Leje Mjedisore të Integruar nga MMPH, Bordi i Rregullatorit, që nga viti 2011 për çdo vit i ka vazhduar licencën për prodhim të energjisë elektrike ndërmarrjes KEK SH.A-TC “Kosova A” (vendimet për vazhdim licence: V_380_2011, datë 30 shtator 2011; V_437_2012, datë 01 tetor 2012; V_556_2013 datë 06 shtator 2013; V_652_2014 datë 03 tetor 2014; V_749_2015, datë 16 korrik 2015; V_843_2016, i datës 03 tetor 2016 dhe V_943_2018 i datës 29 mars 2018), duke obliguar të licencuarin që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të Vendimeve, ta sigurojë nga MMPH Lejen Mjedisore të Integruar, dhe një kopje ta dërgojë në Rregullator.



- Me kërkesë të Rregullatorit, e po ashtu me qëllim të përmbushjes së dispozitave të licencës dhe obligimit të përcaktuar me ligjet në fuqi për Leje të Integruar Mjedisore, edhe gjatë këtij aplikimi për vazhdim licence, KEK SH.A ka dorëzuar në Rregullator përgjigjen nga MMPH lidhur me lejen mjedisore të integruar.
- Në Njoftimit e MMPH-së të datës 11.04.2018 thuhet se: *MMPH ka pranuar aplikacionin për Leje Mjedisore të Integruar dhe është duke e shqyrtuar lëndën në bazë të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, (Ligji Nr. 03/L-043). Duke u nisur nga fakti se KEK-u është ndërmarrje publike me interes vital për Kosovën, MMPH do të mbështesë me një njoftim të praktikuar deri më tani, për kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm, për të vazhduar afatin e licencës. Pasi zbatimi i dispozitave që dalin nga ligji i lartpërmendur kërkon analizë të thellë të gjendjes teknike të instalimeve të KEK-ut (TC "Kosova A"), që paraqesin një kompleks të madh industrial por edhe me një vjetërsi të konsiderueshme, do të kërkohet një bashkëpunim i ngushtë me KEK-un, për të planifikuar përmbushjen e standardeve të përcaktuara me legjislacionin për mjedis dhe dhënien e Lejes së integruar mjedisore.*
- Në po të njëjtin njoftim të cekur më lartë, si shtojcë e saj theksohet se: *Me Planin Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve(NERP) parashihet që TC Kosova A të vazhdoj punën me kusht që të përmbush standardet e parapara me Direktivën e Impianteve me Djegieje të Madhe(Directive 2001/80/EC) deri në vitin 2022 dhe të vazhdoj punën më tutje nëse i përmbush kushtet sipas Direktivës për Emisionet Industriale (Directive 2010/75/EU).*
- Rregullatori duke marrë parasysh këtë që u tha më lartë, dëshmitë e bashkëngjitura aplikacionit për vazhdim licence dhe sipas dispozitave ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A) TC "Kosova A"
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar